

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departementi i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtarja Mevlide Shabani, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani - Rahimi, në çështjen juridiko - civile të paditësit R. T. nga Gj rruga ... , të cilin e përfaqësonnga fshati....., kundër të paditurit Zh.J nga Gjilani të cilin e përfaqëson av.V. P , nga Gj.. për vërtetimin e të drejtës së pronësisë, në bazë të kontratës të shitblerjes dhe mbajtjes, jashtë seancës gjyqësore më dt. 24.11.2016 bie këtë:

A K T G J Y K I M
Në bazë të pohimit-pranimit

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit R. T ,nga Gjilani, kundër të paditurit Zh. J nga Gj dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronar i ngastrave kadastrale nr..... , në sipërfaqe prej....., ngastrës kadastrale nr....., në sipërfaqe prej², ngastrën kadastrale nr.P-.....në sipërfaqe prejtë gjitha në vendin e quajtur ,,, te regjistruara në çertifikatën nr.....prej datës....., të cilat evidentohen në emër të të paditurit Zh.Joviq .

II. DETYROHET i padituri, Zh.J nga Gj, t ia njoh paditësit, të drejtën e pronësisë, të përmbahet, të durojë dhe kjo pasuri e paluajtëshme në DGJKPB të Gj.. pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi, të regjistrohet në emër të paditësit, R.T nga Gj me vërejtjet të përmbarimit të detyruar.

III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës kontestimore kurse paditësi është i detyruar që kësaj gjykate t'ia paguaj shumën e të hollave në lartësi prej 50€, në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimit të aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Paditësi R.T, përmes përfaqësuesit të tij me autorizim B. K nga Gj, në padi-kërkesëpadi kishte konfirmuar se pasurinë e paluajtëshme të cekur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi e kishte blerë në vitin., nga i padituri, duke ja paguar në tërësi çmimin e kontraktuar të shitblerjes në dinarë të atëhershëm, tash të paditurit dhe ka hyrë në posedim dhe shfrytëzim të lirë dhe të qetë të të njëjtave, i pa penguar nga i padituri, familja e tij apo personat e tjerë.

Pas pranimit të padisë, gjykata duke vepruar në pajtim me nenin 394 dhe 395 të LPK-së, pales së paditur i ka dërguar padinë, në mënyrë që i njejt të paraqes përgjigje në padi, ku i padituri,Zh.Jnga Gj përmes të autorizuarit të tij av. ..ka dhënë përgjigje në padi me date 28.10.2016 duke e pranuar kërkesëpadinë e paditësit në tërësi si të bazuar ,duke theksuar faktin se paditësi I kishte blerë këto palujtshmeri nga I padituri që nga viti dhe çmimin e shitblerjes e ka paguar në tërësi dhe prej asaj kohe paditësi këto palujtshmeri i ka në posedim dhe shfrytëzim.

Lidhur me këtë në bazë të provave të bashkangjitura kësaj lënde dhe përgjegjes së të paditurit konstatohet themelësia e kërkespadsë se paditësi është pronar i palujtshmërive kontestuese, të cekura si në dispozitivin e këtij aktgjykimi, ndërsa pasi i padituri e ka pohuar kërkespadinë, gjykata në bazë të nenit 148 par.1, bie aktgjykim në bazë të pohimit-pranimi.

Në bazë të neneit 450 të LPK-ës, gjykata vendosi që sejcila palë i bart shpenzimet e veta të procedurës kontestimore kurse paditësin e detyroj që kësaj gjykate t'ia paguajë shumën e të hollave në lartësi prej 50€, në emër të përpilimit të këtij aktgjykimi, në afat prej 15 ditësh pas ditës së pranimi të aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimi të dhunshëm.

Nga të cekurat më lartë në bazë të nenit 148 par. 1 të LPK-ës Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN

Gjyqtarja
Mevlide Shabani

KËSHILLA JURIDIKE: kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit, në Prishtinë, në afat prej 15 nga pas ditës së pranimi të këtij aktgjykimi. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftuara përmes të kësaj gjykate.